



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Zyra e Kryetarit të Komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 , në bazë të nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe në bazë të nenit 615 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Kryetari i Komunës, shpall:

K O N K U R S

Për kryerjen e punëve dhe detyrave specifike (Kontratë mbi Vepër) Drejtoria për Administratë në Vushtrri

1.Vendet e punës- Zyrtar në Qendrën për Shërbim me Qytetarë

Numri i ekzekutuesve: Tre (3)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës: 40 orë në javë

Paga: Sipas legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve për qytetarë ;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive;

- Pranimi i kërkesave-parashtresave për qytetarë dhe subjekte tjera ;
- Njoftimi i qytetarëve dhe subjekteve tjera lidhur me kërkesat e tyre ;
- Informimi i qytetarëve lidhur me procedurat , afatet kohore për parashtrimin e kërkesave të tyre;
- Mbajtja e dosjeve dhe statistikave të parashtresave dhe kërkesave nga qytetarët.

Kualifikimi profesional:

Diplomë universitare

2.Vendet e punës: Arkivist

Numri i ekzekutuesve dy (2)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës:

Arkivimi i dokumentacionit

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive:

-Zhvillon sistemin elektronik të kompjuterizuar për mbështetje të informacioneve

- Përpunon lëndën arkivore dhe mundëson shfrytëzimin e saj për raste të caktuara;
- Klasifikon, fotokopjon dhe mirëmban materialet që duhet të ruhen në arkiv;
- Përpunon të dhënat në INTRANET.

Kualifikimi profesional:
Diplomë Universitare

3.Vendet e punës: Asistent- Zyrtar për NJKDNJ

Numri i ekzekutuesve dy (2)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Këshillimi për të Drejtat e Njeriut

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

-Ndihmon në hartimin e politikave dhe udhëzimeve në sferën e të drejtave të njeriut brenda komunës së Vushtrrisë ;

-Vlerësimi i implementimit të të drejtave të njeriut në komunën e Vushtrrisë;

-Mbikëqyrja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe kushtet në të cilat ekzekutohen sanksionet ;

-Promovimi, monitorimi dhe raportimi për të drejtat e njeriut;

-Aktivitetet bashkëpunuese me komunën, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të

Kualifikimi profesional:
Diplomë Universitare

Drejtoria për Inspektion- Vushtrri

1.Vendi i Punës: Ekspert nga fusha e Mjedisit

Numri i ekzekutueseve një (1)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i këshillave nga lëmi i mbrojtjes së mjedisit

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

-Inspektimi i pronave, ndërtesave, instalimeve dhe pajisjeve;

-Inspektimi i aktiviteteve të cilat shkaktojnë çrregullim të përgjithshëm në mjedis;

-Mbikëqyrja e gurëthyeseve dhe zonat e ndotura.

Kualifikimi profesional:
Diplomë Universitare

2.Vendet e Punës: Ekspert për Shërbime Publike

Numri i ekzekutueseve dy (2)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i këshillave nga lëmi shërbimeve publike

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

-Mbikëqyrja e kyçje ve në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, dhe infrastrukturën e qytetit dhe fshatrave;

-Mbikëqyrja, mirëmbajtja e rrugëve , shesheve, parqeve si dhe inspektimi i trafikut urban, inspektimi i hapësirave publike, objekteve publike dhe lokaleve për plotësimin e kushteve higjienike sanitare.

Kualifikimi profesional:
Diplomë Universitare

3.Vendet e Punës: Ekspert për Fushën e Sanitarisë

Numri i ekzekutueseve dy (2)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i këshillave nga lëmi i sanitarisë

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive:

-Inspektimi i bizneseve lidhur me regjistrimin e tyre dhe pajisjeve me licencë komunale;

-Përcjellë të dhënat mbi saktësinë e mallit;

-Bënë eliminimin e mallit i cili nuk i plotëson kriteret për treg;

-Bënë inspektimin e lidhur me pranimin e lokaleve afariste me rastin e pajisjeve me licencë komunale, inspektimi i prodhimeve të mishit, lëshimin e vendimeve anti covid për personat e shëruar etj

Kualifikimi profesional:

Diplomë Universitare

4.Vendi i Punës: Ekspert për Fushën e Ndërtimit

Numri i ekzekutueseve një (1)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i këshillave nga lëmi i ndërtimit

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive:

-Përcjellja e punës në ngritjen, instalimin, meremetimin, zgjerimin, ndryshimin, shndërrimin ose rrënimin e çfarëdo ndërtese duke përjashtuar punën e zakonshme për mirëmbajtjen e ndërtesave për të cilat nuk nevojitet leje e ndërtimit ;

-Përcjellë të dhënat mbi saktësinë e mallit;

-Bënë eliminimin e mallit i cili nuk i plotëson kriteret për treg;

Kualifikimi profesional:

Diplomë Universitare

5.Vendi i Punës: Ekspert për Komunikacionit

Numri i ekzekutueseve një (1)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i këshillave nga lëmi i komunikacionit

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive:

-Ndërmerr masa për eliminimin nga trafiku urban publik i subjekteve të cilat nuk janë pajisur me licencë komunale;

-Inspekton trafikun urban dhe parregullsitë në trafikun urban ;

-Përcjellë të dhënat mbi saktësinë e mallit;

-Bënë eliminimin e mallit i cili nuk i plotëson kriteret për treg;

Kualifikimi profesional:

Diplomë Universitare

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

1. Teatri “Adem Mikullovc” – 5 punëtorë/aktorë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi

- Të mësojnë tekstin dhe të mbajnë prova;
- Të diskutojnë interpretimin dhe të shfaqin kreativitet;
- Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale drama që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- Të performojnë drejtpërsëdrejti para publikut;
- Të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin;
- Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e teatrit;
- Të kujdesen për hapësirën performuese, kostumet dhe rekuizitat;
- Të mbajnë në mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo veprë zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë;
- Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e rolit;
- Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së përgjegjësit të teatrit apo drejtorit për kulturë, rini dhe sport në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- Për punën e tyre i përgjigjen regjisorit, dhe përgjegjësit të teatrit.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar. Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare nga Fakulteti i Arteve, drejtimi i Aktrimit. Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- Të dëshmojnë talentin dhe përvojën e tij para audicionit që e organizon Komisioni profesional;

- Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar (njohja e gjuhëve të huaja është përparësi);

Të ketë aftësi të mira për komunikime ndër njerëzore dhe të jenë të gatshëm të punojnë

- me orar fleksibil të punës. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel)

2. Stadiumi i qytetit “Ferki Aliu” – 3 punëtorë (me qëllim që të mund të arrijmë ta mirëmbajmë gjithë investimin e bërë atje)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ruan fushën e futbollit ne Stadium
- Kujdeset për mirëmbajtjen e terreneve dhe barit ne fushën e futbollit,
- Kujdeset për higjienën e zhveshtoreve
- Kujdeset për ofrimin e shërbimeve gjate stërvitjeve
- Kujdeset për objektet tjera përcjellëse te stadiumit te futbollit
- Kryen pune te tjera sipas nevojave dhe kërkesës se drejtorisë

Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme

3.Kalaja e qytetit – Zyra e Turizmit 1 punëtor (të cilin së paku përkohësisht do ta angazhonim për ta prezantuar, si ciceron, trashëgiminë tonë, por edhe zhvillimin e turizmit të komunës sonë).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen punën e ciceronit,
 - pret, shoqëron dhe përcjelle vizitorët,
 - Krijon pako turistike,
 - Bashkëpunon me ciceronet dhe guidat e rajoneve të ndryshme,
 - Bashkëpunon me sektorët e trashëgimisë kulturore dhe rurale,
 - Kryen pune të tjera sipas nevojave dhe kërkesës së drejtorisë
- Përgatitja shkollore: Diplomë Universitare

4.Biblioteka “Naim Frashëri” – 1 punëtor (me të cilin do të mund të paku t’u përgjigjemi kërkesave të vazhdueshme nga lexuesit për zgjatje të orarit të punës në bibliotekë).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Regjistron anëtar të rinjë lexues në bibliotekë
- Hap kartotekën për secilin lexues
- Jep në huazim libra për lexim dhe material tjetër
- Bënë sistemimin dhe radhitjen e librave sipas Kodit Universal Decimal (KUD)
- Bënë përpunimin e materialit në bibliotekë
- Kujdeset për gjendjen e materialit në bibliotekë
- Për punën e vet i raporton mbikëqyrësit
- Kujdeset dhe mirëmban librat në raftet ku janë të
- Kryen pune të tjera sipas nevojave dhe kërkesës së drejtorisë

Përgatitja shkollore: Diplomë Universitare

5.Palestra e Sporteve “Jeton Tërstena” – 2 punëtorë (njëri prej të cilëve duhet të ngarkohet me përgjegjësi për palestrën, ndërsa tjetri si ekspert i fushës së sportit, pasi që kemi aq shumë disiplina sportive me të cilat komuna jonë ka arritur suksese të larta)

Përgjegjës i Palestrës dhe terreneve sportive

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen punën e menaxhimit të Palestrës dhe objekteve tjera shpotive
- Menaxhon me personelin e Palestrës dhe objekteve tjera shpotive,
- Përpilon orarin e shfrytëzimit të palestrës dhe objekteve tjera sportive,
- Koordinon dhe bashkëpunon me klubet sportive,
- Raporton për mbarëvajtjen e punëve në palestrën dhe objektet sportive
- Raporton për shërbimet dhe financat në palestër dhe objekte sportive
- Kryen pune të tjera sipas nevojave dhe kërkesës së drejtorisë

Përgatitja shkollore: Diplomë Universitare

6. Ekspert ne fushën e sportit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton dhe zbaton politika dhe programe te sportit në nivel komunal,
- Merr pjese dhe organizon aktivitetet sportive ne nivel komunal,
- Bashkëpunon me drejtorin e drejtorisë për financimin e programeve sportive,
- Harton planin vjetor të aktivitetet sportive,
- Raporton për punët e kryera në fushën e sportit
- Kryen pune të tjera sipas nevojave dhe kërkesës se drejtorisë

Përgatitja shkollore: Diplomë Universitare

7. Administrator i DKRS-së – 1 punëtor (i cili do të përkujdesej për ligjshmërinë e dokumenteve të DKRS-së, por edhe për në lidhje me çështjet financiare të DKRS-së)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për administratën e DKRS-se,
- Pranon shkresa te ndryshme për DKRS-se
- Asiston dhe bashkëpunon me te gjithë sektorët e DKRS-se ne aspektin administrativ,
- Evidenton dhe protokollon dokumente për DKRS-se
- Administron ne bashkëpunim te plote me Drejtorin e Drejtorisë për çështje administrative
- Kryen pune te tjera sipas nevojave dhe kërkesës se drejtorisë.

Përgatitja shkollore: Diplomë Universitare

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit, dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.

Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

